



20

RAPORTI VJETOR

23

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	01
1. Rritja e Kapaciteteve	03
Lidershipi Politik i të Rinjve – Platforma Ndër-Partiake në Qarkun Durrës	03
Akademia Rajonale (PROGWeB)	04
Tryeza të Rrumbullakëta: “Kandidati Ynë, Zëri Ynë”	05
Trajnim “Sfidat dhe Perspektivat e Qeverisjes Vendore”	05
Trajnimi i Trajnerëve 2023	06
Akademia Politike 2023	08
Tryezë e rrumbullakët “Përdorimi i Automjeteve Elektrike si një Alternativë drejt Mbrojtjes së Mjedisit”	09
Akademia Politike – Integriteti dhe Antikorrupsioni	10
Akademia Sociale – Albania Youth Voice in COP 28	10
Emigrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri	11
2. Politikat Zhvillimore	13
Studim dhe Profilet përkatëse për 5 Bashkitë e Vendit	13
Studim i Përbashkët: Migrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri, Bosnjë-Herzegovinë dhe Maqedonia e Veriut	14
3. Bashkëpunimi dhe Integrimi	16
Paneli për Zhvillimin Demokratik të Ballkanit Perëndimor dhe Aderimin në BE në Kushtet e Pandemisë, Luftës në Ukrainë dhe Krizës Energjetike	16
Forumi Vjetor Rinor i Partive Politike	17
Trajnimi mbi Instrumentet e Financuara nga Bashkimi Evropian	17
Korçula School 2023 “Transforming Politics Through a Gender Lens”	18
Kongres i Socialistes Evropiane, Málaga	18
Takimi i Socialistes Evropiane në Tiranë	19
Konferenca Rajonale Vučko 2023: Gjenerata Z dhe Mobilizimi Politik	19
Vizitë Studimore në Shqipëri: Mathias Corvinus Collegium	20
Tryezë e rrumbullakët “Miq të Ballkanit Perëndimor”	20
Konferenca Rajonale: Shfrytëzimi i Momentit për Zgjerim në Mjedisin e Ndryshuar të Sigurisë Evropiane	21
Takimi Përmbyllës në FQS 2023	21
4. Iniciativa të reja	23

Përmbledhje Ekzekutive

Fondacioni Qemal Stafa (FQS), si një strukturë integrale e Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka si funksion primar asistimin e Partisë Socialiste në procesin politikëbërës në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar me trajnime, ide, studime dhe programe politike. Objektivi kryesor është të forcojë kërkimin e bazuar në statistika dhe metoda studimore për të udhëhequr Partinë Socialiste në nismat dhe zbatimin e politikave kombëtare efikase. Gjithashtu, Fondacioni identifikon dhe vlerëson çështjet aktuale vendore/ndërkombëtare në arenën politike në kuadër të programeve afatgjata të Partisë Socialiste.

Fondacioni Qemal Stafa operon në tre shtylla të rëndësishme që janë:

- Rritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, shkollave verore dhe akademike;
- Politikat zhvillimore nëpërmjet analizave dhe studimeve të thelluara;
- Fuqizimi i network-ut nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit me fondacione simotra, grupe interesi, organizata dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Formimi i liderëve të ardhshëm është një aspekt shumë i rëndësishëm i përmirësimit të procesit të politikëbërjes. Nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në nivel rajonal, Fondacioni synon të nxisë mendimin kritik, të trajnojë të rinjtë e interesuar në fushën e politikave publike si dhe të evidentojë dhe promovojë liderat e së ardhmes. Ekspertët e angazhuar në rritjen e kapaciteteve përbëhen nga akademik të përzgjedhur dhe profesionistë në fusha të ndryshme, të përkushtuar dhe të motivuar për t'u dhënë të rinjve njohuritë teorike dhe praktike. Akademitë janë një formë tjetër ku grupet e interesit kanë mundësinë të zhvillojnë diskutime të hapura me politikanë të shquar, diplomatë, akademikë dhe analistë të njohur, studiues e gazetarë të cilët janë pjesë integrale e këtij procesi. Metoda e mësimdhënies ndërthuret ndërmjet orëve teorike dhe praktike, në formë ligjërata, dialogut dhe mësimi interaktiv, debatit, punës në grup, loja me role, prezantime, simulime etj.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve, Fondacioni mundëson kryerjen e një cikli të plotë teorik dhe praktik duke ofruar trajnime mbi ideologjitë, parimet universale të së majtës tradicionale dhe moderne, modelet ekonomike të së majtës, mirëqeverisja dhe mirëqenia sociale, komunikimi publik dhe mediatik, mendimi kritik dhe analitik në proceset politike, etj.

Ndërkohë, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është një nga shtyllat prioritare të fondacionit. Bashkëpunimi mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor ngelet një nga prioritetet më imediate jo vetëm për rrugën e tyre drejt integritit në BE, por edhe për integrimin ekonomik rajonal midis vendeve fqinje. Të gjitha organizatat dhe iniciativat rajonale synojnë të harmonizohen me agjendat dhe politikat e përafrimit të BE-së. Qëllimi i angazhimit të Fondacionit në bashkëpunim rajonal me fondacionet simotra dhe më gjerë është të promovojë aktivizimin dhe bashkëpunimin afatgjatë dhe afatshkurtër ndër rajonal si një mjet që do të kontribuojë në reduktimin e distancës sociale dhe etnike midis të rinjve në rajon si dhe në formimin e vlerat të tyre pro-sociale dhe evropiane që do të çojnë në pajtim, stabilitet dhe prosperitet në rajon.

Aktivitetet e organizuara dhe aktivitetet në të cilat Fondacioni merr pjesë në kuadër të Bashkëpunimit dhe Integritit kanë si objektiv të përfshijnë të rinjtë, profesionistët dhe liderët politikë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor si nxitës të pajtimit dhe rindërtimit shoqëror, duke u mundësuar atyre të zbatojnë vlerat evropiane, të iniciojnë dhe udhëheqin dialogun ndërkulturor dhe bashkëpunimin rajonal drejt zhvillimit socio-ekonomik dhe demokratik.

**RRITJA E
KAPACITETEVE**

1. Rritja e Kapaciteteve

Një prej shtyllave kryesore të veprimtarisë së Fondacioni Qemal Stafa është rritja e kapaciteteve politike dhe qytetare për të kontribuar në fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri dhe politik nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit qytetar dhe zhvillimit të kapaciteteve për një qeverisje të mirë. Në kuadër të Rritjes së Kapaciteteve Fondacioni Qemal Stafa ka organizuar aktivitetet e mëposhtme:

Lidershipi Politik i të Rinjve – Platforma Ndër-Partiake në Qarkun Durrës

Westminster Foundation for Democracy (WFD), organi publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar forcimit të demokracisë në mbarë botën organizoi trajnimin dy-ditor me të rinjtë shqiptarë në kuadër të platformës ndër-partiake. Trajnimi u mbajt më datat 24-25 shkurt 2023 në qytetin e Durrësit. Përkrah përfaqësuesve të WFD-së, të pranishëm në trajnim ishin edhe përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe kandidatë për kryetar bashkie në Bashkinë e Durrësit.

Gjatë ditës së parë, të rinjtë u trajnuan mbi lidershipin demokratik dhe komunikimin, ku e ftuar ishte Znj. Edlira Gjoni. Në vijim, u zhvillua diskutim i hapur ndërmjet të rinjve dhe Ministres së Shtetit për Rinën dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi mbi Ligjin për Rininë, Strategjinë për Rininë dhe përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. U vu re pjesëmarrja aktive dhe interesi i shfaqur i të rinjve për të mësuar sa më shumë lidhur me këto fusha. Gjatë ditës së dytë të trajnimit u bë prezantimi i platformave për bashkinë e Durrësit nga kandidatët për Kryetar Bashkie, Z. Luan Hoti (PD), Z. Ardian Muka (Shtëpia e Lirisë) dhe Znj. Emirjana Sako (SP). I ftuar në trajnim ishte edhe Z. Ilir Kalemaj i cili u përqëndrua kryesisht tek të rinjtë në politikë dhe përdorimi i të dhënave kërkimore për politikëbërje.

Në përfundim të aktivitetit, të rinjtë u përfshinë në diskutimin dhe finalizimin e listës së prioriteteve të të rinjve drejtuar nga Znj. Vali Qyrfyci. Ky trajnim nga WFD u dha mundësinë të rinjve shqiptarë, jo vetëm të njiheshin dhe të thellonin njohuritë e tyre mbi tema të lidhur me pjesëmarrjen e tyre në politikë, por edhe të shkëmbenin mendime dhe ide me njërin-tjetrin në kuadër të të mirës së përbashkët dhe angazhimit në rritje të tyre në proceset politikbërëse.



Akademia Rajonale (PROGWeB)

Politikat Progressive në Ballkanin Perëndimor (PROGWeB) është një akademi rajonale politike e cila sjellë së bashku socialdemokratët dhe të rinjtë liberalë nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i Akademisë është të rrisë pjesëmarrjen politike dhe ndikimin e të rinjve në shoqëri dhe politikë nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe forcimit të bashkëpunimit demokratik rajonal.

Programi mbështetet nga Olof Palme International Center dhe implementohet nga: Olof Palme International Center (OPC) Centre Party, International Foundation (CIS), Boris Divković Foundation (BDF), Forum of Left Initiative (FLI), Center of Modern Skills (CMS), Progres Institute for Social Democracy (PROGRESS), Liberal Institute Skopje (LIS), Musine Kokalari Institute for Social Policy, si dhe Fondacioni Qemal Stafa (FQS).

Moduli I

PROGWeB 2023 filloi udhëtimin në Qershor në Budva, Mal i Zi, ku të rinj të motivuar morën pjesë në sesione trajnimi mbi politikat progresive dhe u angazhuan në krijimin dhe planifikimin e projekteve kombëtare të ndarë sipas grupeve përkatëse.



Moduli II

Moduli i dytë i akademisë u zhvillua në Zlatibor, Serbi, më datë 29 Korrik 2023. Gjatë këtij moduli, përfaqësuesit e secilit prej shteteve anëtare prezantuan punën e bërë në lidhje me projektet kombëtare, të cilat i kishin ideuar dhe diskutuar më herët gjatë modulit të parë të programit. Nën mbikëqyrjen e ekspertëve të fushës, do të vijojë implementimi i projekteve kombëtare deri në finalizimin e tyre.

Pjesëmarrësit u trajnuan edhe mbi rëndësinë e komunikimit dhe marrëdhënieve publike në politikë, si të promovojnë idetë e tyre dhe si të zhvillojnë strategjitë e PR nëpërmjet mjeteve dhe aktiviteteve të duhura.



Moduli III

Akademia Rajonale për vitin 2023 u finalizua në Sarajevë, Bosnje & Hercegovinë, më datat 12-15 Tetor. Akademia bëri bashkë-politikanët e së ardhmes nga vendet e Ballkanit Perëndimor të cilët për disa muaj me rradhë janë angazhuar në shkrimin e artikujve politikë, si dhe në hartimin dhe zbatimin e projekteve kombëtare individuale.

Artikulli politik u publikua nën titullin “Fuqizimi i rinisë shqiptare drejt përdorimit të makinave elektrike”, ndërsa projekti kombëtar u zbatua nën titullin “Implikimet monetare të kalimit nga makinat me naftë në ato elektrike në Shqipëri”



Tryeza të Rrumbullakëta: “Kandidati Ynë, Zëri Ynë”

Fondacioni Qemal Stafa ka organizuar një seri takimesh në disa bashki të vendit për të diskutuar mbi profilet e bashkive bazuar në një proces të gjatë intervistimesh me qytetarët në terren mbi performancën bashkiake, si dhe mbi sfidat me të cilat priten të përballen bashkitë respektive gjatë mandatit zgjedhor, i cili sapo ka filluar.

Takimet janë organizuar në formën e tryezave të rrumbullakëta, gjatë periudhës Mars-Prill 2023, me pjesëmarrjen e të rinjve, bizneseve dhe përfaqësuesve të niveleve të larta drejtuese. Aktivitetet janë organizuar në kuadër të projektit: “Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike” me mbështetjen e Westminster Foundation for Democracy.



Trajnim “Sfidat dhe Perspektivat e Qeverisjes Vendore”

Fondacioni Qemal Stafa, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, ka organizuar trajnimin dy-ditor me kryetarët e rinj të bashkive të Partisë Socialiste. Trajnimi u zhvillua në datat 07-08 Korrik 2023 në qytetin e Elbasanit.

Ky program trajnimi ofroi një mundësi të vlefshme për rritjen e kapaciteteve të kryetarëve të zgjedhur për herë të parë për të drejtuar në mënyrë sa më eficiente dhe të përgjegjshme bashkitë përkatëse, dhe për të nxitur bashkëpunimin e marrëdhënieve profesionale ndërmjet homologëve në bashkitë e vendit.

Dita e parë e trajnimit u fokusua në rëndësinë e pushtetit vendor në objektivat kryesore, të tilla si rritja e rolit të bashkive në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe rritja e performancës ekonomike të tyre, pjesëmarrja aktive në politikë në nivel lokal dhe rritja e koordinimit me strukturat në nivel qendror, si dhe roli i bashkive në procesin e integritetit evropian. Gjatë ditës së dytë të trajnimit, fokusi ishte në ofrimin e shërbimeve bashkiake sa më gjithëpërfshirëse dhe cilësore për qytetarët.



Trajnimi i Trajnerëve 2023

Fondacioni Qemal Stafa ka organizuar “Trajnimi i Trajnerëve 2023” i cili në bazohet në programin “Mbështetja e demokracisë në Ballkanin Perëndimor – progresi dhe lidhja e urave të bashkëpunimit me një kurrikul të përshtatur që përfshin tri module intensive dhe interaktive, të dizajnuara si një kombinim i prezantimeve teorike dhe aftësive praktike për pjesëmarrësit.

“Trajnimi i Trajnerëve 2023” ka si qëllim të mbështesë individët të cilët duan të angazhohen si trajnerë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e vendim-marrjes, komunikimit në publik dhe drejtimit si shtylla të rëndësishme drejt rrugës së suksesit. Temat e përfshira në këtë trajnim përfshijnë disiplinat e liderimit, sesion mbi komunikimin, median, debatin konstruktiv dhe zhvillimin personal, module këto që kanë vendosur në sfidë secilin nga pjesëmarrësit. Në të tri modulet u angazhuan katër trajnerë, dy prej të cilëve i përkasin grupit të alumnit të Trajnimit të Trajnerëve 2022.

Moduli I

Moduli i parë u zhvillua në datat 09-10 Shtator në Pogradec. Në sesionin e parë pjesëmarrësit u njohën me rëndësinë e zhvillimit të grupeve dhe proceset e krijimit të tyre. Përgjatë këtij sesioni u zhvilluan ushtrime dhe u realizua ndarja në grupe e pjesëmarrësve bazuar në teknikat e mësuara. Në vijim u diskutuan stilet e të mësuarit dhe mësimi përgjatë jetës si një qasje e rëndësishme e të mësuarit individual. Aktivitete sociale në fshatit turistik Tushemisht u zhvilluan në mbyllje të ditës së parë.

Sesionet e ditës së dytë u përqëndruan në Aftësitë Bazë të Trajnuesit 1&2. Pjesëmarrësit diskutuan mbi etikën dhe vlerat në sesionin e parë. Aftësitë komunikuese dhe komunikimi jo-verbal, vlerësuar si aftësitë bazë më të rëndësishme për një trajner u trajtuan në sesionin e dytë.

Në sesionin e fundit, trajnerët diskutuan mbi aftësitë drejtuese dhe debatuese duke përmendur stile dhe qasje të ndryshme të liderimit si dhe aftësitë e menaxhimit të konfliktit. Ky sesion i fundit u shoqërua me lojëra simuluese duke ndarë dhe eksperiencat personale midis pjesëmarrësve në kuadër të rritjes së interaktivitetit dhe bashkëpunimit.



Moduli II

Moduli i dytë u zhvillua në datat 23-24 Shtator në Vlorë. Në ditën e parë të Moduli II, pjesëmarrësit patën mundësi të mësonin mbi Aftësitë Bazë të Trajnuesit 3&4, ku u fol për aftësitë trajnuese, prezantuese, coaching dhe përgatitjen e materialeve të trajnimit duke filluar prej agjendës deri tek formulari i vlerësimit të trajnimit. Në kuadër të rritjes së interaktivitetit dhe bashkëpunimit duke shpresuar në krijimin e një network-u afatgjatë, në mbyllje të ditës u zhvilluan aktivitete sociale sipas dëshirës.

Sesionet e ditës së dytë u përqëndruan në Aftësitë Bazë të Trajnuesit 5 dhe përgatitjen e grupeve për modulin e ardhshëm ku pjesëmarrësit do të simulojnë kryerjen e një trajnimit sipas grupeve përkatëse. Në sesionin e fundit, trajnerët dhe pjesëmarrësit diskutuan dhe u konsultuan mbi temat e mundshme që grupet mund të sjellin për prezantim.



Moduli III

Moduli i tretë u zhvillua në datat 07-08 Tetor në Durrës. Në këtë modul të fundit, përgjatë sesioneve të para të ditës së parë, trajnerët diskutuan mbi përcaktimin dhe përgatitjen e koncept-idesë së trajnimit duke i lënë kohë njëkohësisht grupeve për përgatitjen e prezantimit të trajnimit që duhet të simulojnë. Pas përgatitjes në grup për prezantimet, pjesëmarrësit patën mundësi të qetësohen dhe të angazhohen në aktivitetet sociale të organizuara përgjatë bregdetit të Durrësit.

Dita e dytë e modulit të tretë nisi me prezantimin e Grupit të Parë, të cilët kishin zgjedhur të flisnin për temën “Inteligjenca Emocionale”. Grupi i dytë foli për një temë teknike por shumë të rëndësishme si “Fuqizimi i të rinjve: Ndikimi dhe rëndësia e të rinjve në aktivizëm dhe vullnetarizëm”. Grupi i tretë mbylli prezantimet me temën “Angazhimi i të rinjve për qytetari aktive”. Në sesionin e fundit, trajnerët dhe pjesëmarrësit vlerësuan punën e grupeve duke paraqitur argumente dhe komente mbi përgatitjen e materialeve dhe prezantimin e secilit prej pjesëmarrësve gjatë simulimit. Në përfundim të modulit, drejtori ekzekutiv Z. Ledjon Shahini dhe Zj. Romina Kuko, anëtare e bordit drejtues të Fondacionit shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes.

Përgjatë këtyre tre moduleve intensive, pjesëmarrësit u njohën me bazat teorike dhe praktike të të qenurit një trajner. Me përfundimin e trajnimit individët do të nisin një angazhim afatgjatë me Fondacionin Qemal Stafa duke u bërë pjesë në aktivitete të ndryshme, si dhe duke u përfshirë si trajnerë për aktivitetet e ardhshme të fondacionit.



Akademia Politike 2023

Fondacioni Qemal Stafa ka organizuar “Akademia Politike 2023”, e cila bazohet në programin “Mbështetja e Demokracisë në Ballkanin Perëndimor – Progresi dhe Lidhja e Urave të Bashkëpunimit” në bashkëpunim me Fondacionin Kalevi Sorsa.

Formimi i liderëve politikë të ardhshëm është një aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të procesit të politikëbërjes. Nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në nivel kombëtar, Akademia Politike 2023 ka si synim nxitjen e mendimit kritik, trajnimit, evidentimit dhe promovimin e individëve që kanë ambicie dhe dëshirojnë të jenë pjesë aktive e jetës politike në vend. Nëpërmjet Akademisë Politike pjesëmarrësit patën mundësinë të kuptojnë më gjerë mjedisin kompleks politik, social dhe ekonomik dhe të njiheshin me procesin e rëndësishëm të integritimit në Bashkimin Evropian. Objektivi i Akademisë Politike 2023 ishte t'u ofronte pjesëmarrësve njohuri dhe ekspertizë teknike për të rritur aftësitë e tyre për të formësuar argumente politike të sakta.

Moduli I

Akademia Politike 2023 u hap me fjalën e drejtorit ekzekutiv të Fondacionit, Z. Ledjon Shahini. Sesioni i dytë u mbajt nga Prof. Dr. Ardian Civivi, Rektor i Universitetit Mesdhetar në Shqipëri. Në këtë sesion u prezantua një spectrum i përgjithshëm ndërmjet ideologjive kryesore dhe u diskutuan me pjesëmarrësit avantazhet dhe disavantazhet e secilës ideologji.

Në ditën e dytë të Modullit I, u trajtua lidhja që ekziston midis sistemeve politike dhe atyre ekonomike nga drejtori ekzekutiv i Fondacionit, Z. Ledjon Shahini. Në vijim Zj. Ana Verushi, Kryetare e Këshillit Bashkiak të Korçës, foli dhe diskutoi me pjesëmarrësit mbi sistemet mbizotëruese politiko-ekonomike në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë ku me interes u trajtuan dallimet midis tyre. Gjithashtu, në këtë sesioniu dha përgjigje pyetjes: Sa konvergjojnë sistemet politike dhe ekonomike në Shqipëri?

Moduli i parë i Akademisë Politike 2023 u zhvillua në datat 16-17 shtator 2023 në Pogradec ku pjesëmarrësit patën mundësi të zhvillonin dhe aktivitete sociale në përfundim të ditës së parë.



Moduli II

Moduli i dytë dhe i fundit i Akademisë Politike 2023 u zhvillua në datat 30 shtator - 01 tetor 2023 në Durrës. Ky modul u hap me fjalën e drejtorit ekzekutiv të Fondacionit, Z. Ledjon Shahini dhe u përshëndet nga Znj. Jelenca Simic, Menaxhere Programi për organizatën partnere Kalevi Sorsa Foundation. Prof. Assoc. Gentian Elezi, Universiteti i Tiranës (Instituti i Studimeve Evropiane) mbajti sesionin mbi historikun e integritimit evropian të Shqipërisë dhe negociatat e anëtarësimit duke i kushtuar vëmendje të veçantë kapitujve të negociatave dhe strategjisë së negociimit me institucionet Evropiane.

Dita e dytë e modulit nisi me diskutime të shumta në lidhje me sfidat e integritit dhe prespektivat e pranimit në Bashkimin Evropian për Shqipërinë. Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën finlandeze, sesioni i parë u mbajt nga ambasadori finlandez në Kosovë Z. Matti Nissinen. Në këtë sesion të mbajtur në gjuhën angleze u fol mbi Integrimin Evropian dhe bashkëpunimin politik nga periudha e krizës Evropiane deri në zhvillimin e luftës Rusi-Ukrainë dhe prespektivën e mundshme të integritit të Ukrainës së bashku me vendet e Rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Në mbylljen të Akademisë Politike 2023, Znj. Romina Kuko, Zëvendësministër i Brendshëm dhe njëkohësisht pjesë e bordit drejtues të Fondacionit dhe Z. Julian Hodaj, Zëvendësministër i Brendshëm, zhvilluan diskutime mbi Kapitujt e Negociatave për Integrimin Evropian (Respektivisht Kapitulli 22: Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore; dhe Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria). Në përfundim të trajnimit u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së certifikatave, ku pjesëmarrësit sipas dëshirës shprehen komentet dhe vlerësimin e tyre për programin e Akademisë Politike 2023.



Tryezë e Rrumbullakët “Përdorimi i Automjeteve Elektrike si një Alternativë drejt Mbrojtjes së Mjedisit”

Në kuadër të programit të akademisë rajonale “Progressive Politics in Western Balkans (PROGWeB)”, skuadra e të rinjve shqiptarë organizuan aktivitetin me të rinjtë që përfaqëjnë qasjet pro-mjedisore në 6 Tetor 2023 në Tiranë.

Anëtarët e grupit që përfaqësojnë Shqipërinë në PROGWeB prezantuan idenë që qëndron pas Akademisë Rajonale, si dhe qëllimin e projektit kombëtar shqiptar, duke ftuar të rinjtë të aplikojnë për aktivitetet e radhës PROGWeB. Eventi i organizuar shpërndau tek rinjtë shqiptarë njohuritë dhe entuziazmin për të përqaftuar automjetet elektrike, si një element kryesor në formësimin e një të ardhmeje më të gjelbërt dhe më të qëndrueshme. Eventi nuk ishte vetëm një mundësi për të eksploruar përfitimet mjedisore të makinave elektrike, por edhe një platformë për rrjetëzimin e të rinjve, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve.



Akademia Politike – Integriteti dhe Antikorrupsioni

Fondacioni Qemal Stafa organizoi Akademinë Politike “Integriteti dhe Antikorrupsioni” në një trajnim dy-ditor me të rinj nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë. Akademia Politike ka si qëllim kryesor rritjen e kapaciteteve të të rinjve shqiptarë në fushën e Integritetit dhe Antikorrupsionit. Trajnimi u organizua më datë 11-12 Nëntor 2023 në qytetin e Tiranës me mbështetjen e Olof Palme International Center.

Gjatë trajnimit u diskutua mbi konceptin e korrupsionit dhe evoluimin e tij përgjatë kohës, duke u fokusuar në veçanti te tipet e korrupsionit, shkaqet dhe efektet e tij në shoqëri dhe në ekonomi. Pjesë integrale shumë e rëndësishme e trajnimit ishte diskutimi mbi strategjitë antikorrupsion.

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, pjesëmarrësit u trajnuan edhe mbi parimet e integritetit, politikat antikorrupsion dhe transparencën. Të rinjtë u bënë pjesë e punëve në grup, duke nxitur kreativitetin dhe duke ndarë njohuritë me njëri-tjetrin.



Akademia Sociale – Albania Youth Voice in COP 28

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike 2023 ose Konferenca e Palëve të UNFCCC, e quajtur më shpesh COP, do të jetë konferenca e 28-të e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e cila do të mbahet nga data 30 nëntor deri më 12 dhjetor 2023, në Expo City Dubai. Konferenca është mbajtur çdo vit duke filluar nga marrëveshja e parë e OKB-së për klimën në 1992, dhe përdoret nga qeveritë për t'u dakordësuar mbi politikat dhe për të kufizuar rritjen e temperaturës globale dhe për t'u përshtatur me ndikimet që lidhen me ndryshimet klimatike.

Konsideruar ndryshimet klimaterike dhe rëndësinë e impaktit të tyre në çdo fushë të jetës, me mbështetjen e Olof Palme International Center, Fondacioni Qemal Stafa, si një Fondacion që ka për qëllim asistimin në procesin politikëbërës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me ide, udhëzime, studime dhe programe politike, në bashkëpunim me Këshillin Mjedisor të Tiranës, organizoi Akademinë Sociale në fushën mjedisore me temë: “Albania Youth Voice in COP 28”.

Akademia Sociale u mbajt në Tiranë më datë 16 Nëntor 2023 dhe u organizua në formën e 5 tryezave të rrumbullakëta të mbajtura njëkohësisht ku të rinjtë patën mundësinë të ngrejnë ngrenë shqetësimet e tyre mbi impaktin që ndryshimet klimaterike kanë në të tashmen dhe në të ardhmen e tyre, duke dhënë edhe propozimet e tyre mbi zgjidhje të mundshme.




Emigrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri

Fondacioni Qemal Stafa organizoi trajnimin “Emigrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri” në një trajnim dy-ditor (18-19 Nëntor 2023) me të rinj nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë.

Migrimi i të rinjve është një nga problematikat me urgjencën më të madhe për shoqërinë shqiptare. Shqipëria renditet ndër vendet me normat më të larta të migrimit të të rinjve dhe “largimin e trurit”. Përtej problematikave ekonomike dhe sociale që ky fenomen sjell, ndikimi në demokraci është ndër më të rëndësishmit dhe më pak të diskutuarit në të njëjtën kohë.

Përgjatë ditës së parë, pjesëmarrësit u njohën me historikun dhe situatën aktuale të migrimit në Shqipëri. Në vijim u diskutuan sfidat kryesore me të cilat të rinjtë përballen dhe ndikojnë në cilësinë e tyre të jetesës duke përfshirë dhe një krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Në sesionin e fundit, u diskutua marrëdhënia që ekziston midis migrimit të të rinjve dhe demokracisë në Shqipëri duke ndarë rezultate nga pyetësi dhe studimi i realizuar nga Fondacioni Qemal Stafa në lidhje me këtë temë. Ditën e dytë pjesëmarrësit u ndanë në grupe pune dhe prezantuan konkluzionet e tyre në lidhje me politikatat që duhen të ndërmerren nga qeveria në mënyrë që të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre në Shqipëri.



**POLITIKAT
ZHVILLIMORE**

2. Politikat Zhvillimore

Politikat zhvillimore janë jetike për të avokuar ndryshimet sociale dhe për të ndikuar në politika duke plotësuar boshllëqet e njohurive, monitoruar efektivitetin e programeve të ndryshme dhe duke kontribuar në vendimmarrjen e informuar. Fondacioni Qemal Stafa është angazhuar në përgatitjen e analizave dhe studimeve të thelluara si më poshtë:

Studim dhe Profilet përkatëse për 5 Bashkitë e Vendit

Në kuadër të projektit: “Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike” me mbështetjen e Westminster Foundation for Democracy janë përgatitur dhe publikuar profilet e disa bashkive të vendit bazuar në një proces të gjatë intervistimesh me qytetarët në terren mbi performancën bashkiake, si dhe mbi sfidat me të cilat priten të përballen bashkitë respektive gjatë mandatit zgjedhor 2023-2027.

Prezenca në terren, kontaktet me njerëzit, bisedat me qytetarët janë thelbësore për të kuptuar më mirë nevojat e tyre. Nëpërmjet këtij projekti synohet evidentimi i nevojave dhe problematikave që lidhen me pushtetin vendor, për të cilat banorët dëshirojnë të adresohen nga kryetarët e bashkive përkatëse.

Projekti u zbatua në 5 bashki të Shqipërisë si më poshtë:

- Durrës;
- Elbasan;
- Korçë;
- Lezhë;
- Shkodër.

Aktivitetet ku janë prezantuar studimet janë organizuar në forume, në formën e tryezave të rumbullakëta, nën moderimin e ekspertëve të angazhuar në shkrimin e tyre. Në këto tryeza të rumbullakëta kanë marrë pjesë drejtues të lartë, të mesëm dhe të rinj të Partisë Socialiste dhe aktorë të tjerë të grupeve të interesit.

Studim i Përbashkët: Migrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri, Bosnjë-Herzegovinë dhe Maqedonia e Veriut


Në kuadër të bashkëpunimit me Fondacionin Kalevi Sorsa dhe bashkëpunimit rajonal me fondacionet simotra u realizua studimi i përbashkët: Migrimi i të Rinjve dhe Demokracia në Shqipëri, Bosnjë-Herzegovinë dhe Maqedoninë e Veriut. Të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç janë një burim i rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë si dhe të Ballkanit Perëndimor (BB6).

Rajoni karakterizohet nga nivelet të larta të migrimit të të rinjve. Në të gjithë rajonin, mesatarisht 52 përqind e të rinjve raportuan se e parashikojnë veten të jetojnë jashtë rajonit në 10 vitet e ardhshme (55 përqind e meshkujve dhe 50 përqind e femrave) ku Evropa Perëndimore shfaqet në masë dërrmuese si një destinacion në vizionet e rinisë. Vetëm rreth 5 për qind e tyre e parashikuan veten të jetonin brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria ka përqindjen më të lartë të atyre që shprehin interes për migriminku 70 përqind e të rinjve e shohin veten duke jetuar jashtë brenda një dekade.

Në këtë kontekst, studimi i realizuar synon të adresojë problematikat e të rinjve në Shqipëri dhe të vlerësojë arsyet dhe pasojat e migrimit të të rinjve. Specifikisht, studimi analizon lidhjen e migrimit të të rinjve dhe demokracisë në Shqipëri, Bosnjë-Herzegovinë dhe Maqedoninë e Veriut. Për zhvillimin e përgjithshëm dhe prosperitetin ekonomik, institucionet politike janë vendimtare. Është thelbësore të kuptohet se cilët faktorë dhe si këta faktorë ndikojnë në nivelin e cilësisë së këtyre institucioneve dhe proceset demokratike të vendit. Në kuadër të studimit, për të vlerësuar në mënyrë empirike arsyet e migrimit dhe ndikimin e migrimit në demokracinë e vendit, janë krijuar dhe shpërndarë pyetësor tek të rinjtë. Pyetësorët janë analizuar dhe përfundimet janë diskutuar në studim.

migration rates (Frédéric Docquier & Hillel Rapoport, 2011). In the case of Albania, it is difficult to assess such correlation as the data on democracy index have been evaluated starting only from 2011. The data on migration also have problematics of their own given that Albanians resident are not systematically registered when they leave the country and, given that there are few incentives for them to register their departure with local authorities, there is no reliable measurement of the number of individuals who have left Albania. However, it is possible to use indirect methods to estimate the number of individuals who migrated (Migration in Albania, 2017).


Figure 21. Democracy and migration rate over time in Albania, 2023




Source: The Economist Intelligence Unit, DSTAT, Author's calculations, 2023

From the available data for the period 2011-2022, as shown in the Figure. 14, there is no clear relationship or correlation between the democracy index and migration rate (number of migrants over the total population).

Figure 23. Educational background of the questionnaire respondents (%)



Source: Author's calculations based on questionnaires' data, 2023



Source: Author's calculations based on questionnaires' data, 2023

Questionnaire data shows what all the other studies have confirmed on reasons why young people leave Albania. The main reasons continue to be economic conditions with 24% followed by education (14%). The level of corruption and instability are among top 10 reasons and amount for 10% and 9% of the responses.

Figure 28. Pull factors of youth migration in Albania (%)



**BASHKËPUNIMI DHE
INTEGRIMI**

3. Bashkëpunimi dhe Integrimi

Rëndësia e bashkëpunimit rajonal theksohet nga dy përfitime kryesore. Së pari, ai redukton tensionin dhe forcon stabilitetin rajonal, i cili nga ana tjetër është një parakusht kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin. Së dyti, sjell përfitime të ndryshme praktike. Këto të fundit rrjedhin nga rritja e flukseve tregtare, si dhe nga shkëmbimet shkencore dhe kulturore. Sfidat kryesore ekonomike dhe sociale të rajonit mund të adresohen në mënyrë më efikase me përpjekje të përbashkëta dhe të koordinuara në nivel rajonal.

Për këto arsye, Fondacioni Qemal Stafa i kushton rëndësi të veçantë krijimit të marrëdhënieve rajonale dhe më gjerë. Në kuadër të krijimit të urave të komunikimit dhe bashkëpunimit me organizatat simotra dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në rajon dhe në Evropë, Fondacioni ka organizuar dhe ka marr pjesë në aktivitetet dhe trajnimet e mëposhtme:


Paneli për Zhvillimin Demokratik të Ballkanit Perëndimor dhe Aderimin në BE në Kushtet e Pandemisë, Luftës në Ukrainë dhe Krizës Energjetike

Në fillim të vitin 2023, në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, Fondacioni Kalevi Sorsa zhvilloi Panelin për Zhvillimin Demokratik të Ballkanit Perëndimor dhe Aderimin në BE në Kushtet e Pandemisë, Luftës në Ukrainë dhe Krizës Energjetike me pjesëmarrjen e fondacioneve simotra të BP6.

Në këtë panel u diskutua rruga dhe proceset demokratike të përbashkëta të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian duke u ndaluar veçanërisht tek Procesi i Berlinit. Pushtimi i Ukrainës nga Rusia e ka bërë edhe më të nevojshme përshpejtimin e rrugës drejt BE si dhe fokusin në mosmarrëveshjet dypalëshe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në kushte të krizave të njëpasnjëshme, pandemisë, luftës në Ukrainë dhe krizës energjetike, paneli diskutoi influencën e Rosisë dhe Kinës në rajon. Ballkani Perëndimor është shfaqur si një front në konfrontimin gjeopolitik të Rosisë me Perëndimin. Ky konfrontim është i rrënjosur thellë në gjeografinë e përbashkët si dhe në shprehjen e sistemeve, vlerave dhe ideologjive të ndryshme politike. Ndikimi ekonomik i Rosisë është më i madhi në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnj & Herzegovinë, ku furnizon afër 100% të nevojave për gaz.

Ndërkohë, shfaqja e Kinës si një fuqi në Ballkanin Perëndimor gjatë dekadës së fundit është ndër zhvillimet më të rëndësishme gjeopolitike në Evropë. Si një element i përpjekjeve të ndërkombëtarizimit për të zgjeruar gjurmën e tij globale, Kina ka punuar për të përmirësuar pozicionin e saj në disa sektorë kyç, si energjia dhe infrastruktura në Ballkanin Perëndimor. Marrëdhëniet tregtare midis Kinës dhe Ballkanit Perëndimor, gjithashtu, janë rritur me shpejtësi gjatë dekadës së fundit. Ndërsa BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i rajonit, me mbi 70% të vëllimit të përgjithshëm tregtar, Kina është bërë partneri i dytë më i rëndësishëm tregtar i rajonit.



Forumi Vjetor Rinor i Partive Politike

Fondacioni Qemal Stafa u bë pjesë aktive e Forumit Vjetor me Rininë e Partive Politike i organizuar nga Fondacioni Westminster Foundation për Demokraci dhe mbështetur nga Ambasada Britanike më 31 Mars 2023 në Tiranë. Aktiviteti vjetor u mbajt në kuadër të platformës ndërpartiake që WFD organizon me të rinjtë shqiptarë të partive politike të vendit. Forumi Vjetor Rinor i Partive Politike mbledhi bashkë për herë të parë mbi 100 të rinj nga partitë kryesore politike në Shqipëri për të diskutuar mbi rëndësinë e të pasurit integritet në politikë dhe veçanërisht përpara zgjedhjeve vendore të 14 majit.

Zëvendës Ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar znj. Mia Marzouk, Drejtori i WFD, z. Sokol Haxhiu, Komisioneri Celibashi, deputetë, drejtues të rinjsh, përfaqësues të njohur të shoqërisë civile dhe medias, si dhe profesionistë të shquar nga fusha të ndryshme, morën pjesë dhe ndanë mendimet e tyre lidhur me nevojën e madhe për të pasur integritet në politikë në Shqipëri, si dhe rolin që mund të ketë të rinjtë për të thirrur dhe nxitur të tjerët për më shumë integritet.





Trajnimi mbi Instrumentet e Financuara nga Bashkimi Evropian

Fondacioni Qemal Stafa, së bashku me Forum of Left Initiative dhe Progress Institute for Social Democracy, organizatat simotra nga Bosnje & Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, janë bashkuar në programin e trajnimit disa ditor të organizuar me mbështetjen e Kalevi Sorsa Foundation.

Programi i trajnimit u zhvillua më datat 29 Maj – 2 Qershor 2023 në qytetin e Vlorës dhe kishte në fokus instrumentet e financuara nga Bashkimi Evropian. Gjatë këtyre ditëve pjesëmarrësit u trajnuan në detaje mbi hallkat në ciklin e një projekti, duke filluar që nga kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për kontratat e granteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe zhvillimi i aplikimit për grante e deri te raportimi i projekteve.

Trajnimi ofroi mundësinë që të pranishmit të diskutonin mbi planet konkrete të ardhshme, si dhe rriti mundësinë e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet organizatave simotra nga vendet e Ballkanit Perëndimor me qëllim forcimin e ndikimit dhe shtrirjes së veprimtarive të tyre në rajon.



Korçula School 2023 “Transforming Politics Through a Gender Lens”

Fondacioni Qemal Stafa mori pjesë në mënyrë aktive në Akademinë Politike mbi transformimin e politikës parë në këndvështrimin gjinor. E iniciuar në vitin 2012 nga Rrjeti i EQL-së për Çështjet Gjinore, Shkolla e Korçulës është një hapësirë unike e të menduarit të lirë për një shkëmbim largpamës të pikëpamjeve mbi çështje kritike ideologjike dhe politike.

Shkolla mbledh së bashku gra dhe burra udhëheqës politikë nga partitë e qendrës së majtë dhe social-demokrate, ekspertë, aktivistë politikë dhe feministë, veçanërisht nga Evropa Juglindore, për të diskutuar çështjet e barazisë gjinore. Ky edicion ishte një ngjarje e nivelit të lartë që mbledhi së bashku përfaqësues nga rajoni dhe Evropa për të ndarë mësimet e nxjerra nga konfliktet ballkanike të viteve '90 që mund të jenë të rëndësishme për luftën aktuale në Ukrainë dhe zgjidhjen e saj. Në adresimin e temave të mësipërme u aplikuan lente gjinore.

Diskutimet e ditës së parë u krijuan për të qenë të ndërlidhura dhe për të ofruar një perspektivë më gjithëpërfshirëse mbi dallimet, ngjashmëritë, pasojat dhe zgjidhjet që lidhen me gjendjen aktuale të çështjeve në lidhje me luftën në Ukrainë dhe në Ballkanin Perëndimor. Dita e dytë u kushtua socialdemokracisë nga një perspektivë evropiane dhe rajonale.

Akademia Politike u zhvillua në data 25-26 Gusht 2023 në Korçula, Kroaci dhe u organizua nga CEE Gender Network me mbështetjen e Olof Palme International Center, Fondacioni për Studime Evropiane Progresiste dhe Fondacioni Friedrich Ebert.



Kongres i Socialistes Evropiane, Málaga

Fondacioni Qemal Stafa merr pjesë në Kongresin e Socialistes Evropiane për vitin 2023: Evropa në krye: Zgjidhje progresive për sfidat globale. Kongresi u mbajt në datat 10-11 Shtator 2023, Málaga, Spanjë, organizuar nga Partia Socialiste e Punëtorëve Spanjolle, PSOE.

Pjesëmarrësit përfshinë krerët e shteteve dhe qeverive, drejtuesit e partive, liderë, aktivistë dhe mbështetës nga e gjithë Evropa. Në kongres mbajtën fjalën e tyre Z. Stefan Lofven, Presidenti i PES; Z. Pedro Sanchez, Kryeministri i Spanjës dhe PSOE; Z. Olaf Scholz, Kancelari i Gjermanisë; Z. Josep Borrell fontalles, Zv. Presidenti i Komisionit Evropian; Z. Albin Kurti, Kryeministri i Kosovës dhe shumë figura të larta politike të Evropës.

Kongresi i PES synon të përcaktojë prioritetet politike të familjes socialiste. Krahas zgjedhjeve për leadership, Kongresi gjithashtu miratoi një rezolutë të përqendruar në çështjet kyçe për PES, duke vendosur terrenin për zgjedhjet e ardhshme evropiane.



Takimi i Socialistes Evropiane në Tiranë

Fondacioni Qemal Stafa organizon në Tiranë takimin e iniciuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Socialistes Evropiane me pjesëmarrjen e veçantë të Sekretares së Përgjithshme të Internacionales Socialiste, Znj. Benedicta Lasi. Takimi u organizua në kuadër të takimit të Sekretarëve të Marrëdhënieve me Jashtë të partive simotra në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë këtij takimi pune u ngrit në një nivel tjetër rrjeti i bashkëpunimit në rajon, i finalizuar me formalizimin e një protokollit konkret veprimi për hapat vijuese.

Takimi u mbajt më 29 shtator 2023 në ambientet e Partisë Socialiste dhe vijoi me një vizitë të ftuarëve në Muzeun Kombëtar i Përgjimeve: “Shtëpia me Gjethe”.



Konferenca Rajonale Vučko 2023: Gjenerata Z dhe Mobilizimi Politik

Fondacioni Qemal Stafa mori pjesë aktivisht në Konferencën Rajonale tradicionale VUČKO të organizuar nga Friedrich Ebert Stiftung dhe Forumi Left Initiative. Gjenerata Z dhe Mobilizimi Politik ishin dy temat e trajtuara në konferencën Vučko 2023, ku morën pjesë të rinj nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje & Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Sllovenia. Të rinjtë u bënë pjesë dhe diskutuan mbi mënyrën se si gjenerata Z ofron një potencial për të tashmen, duke krijuar një të ardhme, e cila do krijojë ura komunikimi në Ballkanin Perëndimor. Konferenca u mbajt më 06-08 Tetor 2023 në qytetin e Sarajevës.



Vizitë Studimore në Shqipëri: Mathias Corvinus Collegium

Fondacioni Qemal Stafa organizoi në datat 13 – 14 Nëntor vizitën studimore me Mathias Corvinus Collegium në kuadër të vendosjes së marrëdhënieve dhe nxitjes së bashkëpunimit. Mathias Corvinus Collegium (MCC) është institucioni më i madh arsimor privat i Hungarisë i vendosur në Budapest, Hungari i cili synon të ofrojë arsim akademik përtej kornizës tradicionale për studentët e të gjitha moshave nga Hungaria dhe jashtë saj.

Përveç programeve të tij të trajnimit, MCC ofron programe të ndryshme mobiliteti dhe bursash, boton libra dhe artikuj shkencorë, organizon konferenca dhe forume ndërkombëtare dhe vendase për të promovuar dialogët dhe diskutimet demokratike.

Përgjatë ditës së parë, përfaqësuesit e MCC zhvilluan takime me përfaqësuesit e Fondacionit Qemal Stafa dhe përfaqësuesit e Partisë Socialiste. Në ditën e dytë, takimet u përqendruan në institucionet kryesore (Ministria e Edukimit dhe Sporteve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët si dhe Universiteti i Tiranës) me të cilat bashkëpunimi do të ishte tepër i frytshëm.



Tryezë e rrumbullakët “Miqhtë e Ballkanit Perëndimor”

Fondacioni Qemal Stafa si pjesë e rrjetit “Miqhtë e Ballkanit Perëndimor” mori pjesë në tryezën e rrumbullakët në datat 23-25 Nëntor 2023 në Sarajevë, Bosnje & Hercegovinë organizuar nga FEPS.

Misioni i rrjetit “Miqhtë e Ballkanit Perëndimor” është t'u ofrojë parlamentarëve të BE-së më shumë njohuri dhe informacion mbi situatën aktuale në Ballkanin Perëndimor dhe gjendjen e procesit të zgjerimit. Për më tepër, rrjeti do të ofrojë mundësi për shkëmbime perceptimesh dhe idesh me palët e interesuara të Ballkanit Perëndimor dhe do të mbështesë lidhje më të ngushta ndërmjet BE-së dhe socialdemokratëve të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë tryezë, Miqtë e Ballkanit Perëndimor trajtuan temat në diskutim në sinergji me Forumin Evropian për Demokraci dhe Solidaritet. Në kushtet kur vendet e rajonit janë të prekshme nga ndikimi në rritje i regjimeve autoritare, si Kina, Rusia, Turqia dhe Hungaria në këtë tryezë është diskutuar ndikimi i kësaj ndërhyrje. Në këtë aspekt është e rëndësishme të jepen zgjidhje sesi mund të rritet qëndrueshmëria e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe çfarë duhet të bëjnë progresistët evropianë në këtë drejtim.



Konferenca Rajonale: Shfrytëzimi i Momentit për Zgjerim në Mjedisin e Ndryshuar të Sigurisë Evropiane

Fondacioni Qemal Stafa mori pjesë aktive në Konferencën Rajonale me temë “Shfrytëzimi i Momentit për Zgjerim në Mjedisin e Ndryshuar të Sigurisë Evropiane” të organizuar në datat 02-03 Dhjetor 2023 në Shkup, Maqedoni e Veriut nga Progres Institute for Social Democracy (PROGRESS), me mbështetjen financiare të Fondacionit Kalevi Sorsa.

Paneli i parë i ngritur në kuadër të kësaj konference u titullua “Situata aktuale gjeopolitike – Implikimet për Ballkanin Perëndimor”. Qëllimi i këtij paneli ishte diskutimi mbi rolin e ri gjeopolitik të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor dhe cilat janë kostot e jo-integrimit në BE. Në kushtet e konflikteve Rusi-Ukrainë, u diskutua gjithashtu roli i BE dhe NATO-s në garantimin e sigurisë në rajon dhe implikimet e këtij konflikti në procesin e integrimit të vendeve të BP. Gjatë panelit të dytë të organizuar u diskutua mbi procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe metodologjinë e ndryshuar të zgjerimit. Panelistët ndanë shpjegime të qarta të metodologjisë ekzistuese dhe asaj të ndryshuar duke paraqitur avantazhet dhe disavantazhet, porë nga perspektiva e vendeve candidate për anëtarësim në BE.

Paneli i tretë u zhvillua me temën “Statusi aktual dhe rruga e ardhshme e gjashtë vendeve të BP”. Në këtë panel u diskutuan statutet aktuale të secilit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian. Në kuadër të këtij paneli u diskutua gjithashtu sesi politikat e brendshme të vendeve ndikojnë në procesin e zgjerimit. Tema e panelit të fundit ishte “Vendet e Ballkanit Perëndimor në BE”. Qëllimi i këtij paneli ishte të diskutohej se çfarë e pret Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në rrugën e integrimit të Bashkimit Evropian dhe cilat do të jenë sfidat e ardhshme.



Takimi Përmbyllës në FQS 2023

Pranë zyrave të Fondacionit Qemal Stafa në datën 21 dhjetor u mbajt takimi përmbyllës për vitin 2023. Në këtë takim u ftuan pjesëmarrësit e aktiviteteve dhe bashkëpunëtorët e Fondacionit për vitin 2023. Përtej falënderimeve, në këtë takim u diskutua puna dhe prezenca e Fondacionit në aktivitetet ndërkombëtare përgjatë vitit 2023 duke kërkuar feedback dhe mendime të vlefshme sesi mund të përmirësohemi. Gjithashtu, pjesëmarrësit u njohën me planin e aktiviteteve për vitin 2024 si dhe mundësitë për trajnim dhe pjesëmarrje në aktivitetet e ardhshme.



INICIATIVA TË REJA

4. Iniciativa të Reja

Iniciativat për të gjetur mundësi të reja në mënyrë që të rritet sa më shumë impakti i Fondacionit në shoqëri, janë të vazhdueshme. FQS në mënyrë konsistente ka zhvilluar një sërë takimesh me institucione të ndryshme për të krijuar ura bashkëpunimi. Nëpërmjet këtyre takimeve është arritur me sukses bashkëpunimi me Fondacionin Max van der Stoel.

Në vitin 2024, Fondacioni Qemal Stafa me mbështetjen e Fondacionit Max van der Stoel do të zhvillojë Debatin Rinor Kombëtar. Ky projekt është planifikuar të përbëhet nga 3 nën-aktivitete në secilin nga 3 rajonet e Shqipërisë dhe një aktivitet përfundimtar i planifikuar të organizohet në Tiranë. Në secilin prej aktiviteteve që do të zhvillohen në tre rajonet, do të marrin pjesë 12 të rinj, të cilët do të sfidojnë njëri-tjetrin në debate për fusha aktuale të spektrit të ndryshëm, duke përzgjedhur më të mirët e secilit rajon. Tre pjesëmarrës në çdo qark do të përzgjidhen për të qenë pjesë e aktivitetit final në Tiranë. Fituesit në nivel rajoni do të garojnë me njëri-tjetrin në garën finale për të përzgjedhur tre fituesit përfundimtarë, të cilët më pas do të përfshihen në struktura të ndryshme të PS-së.

Gjithashtu FQS aplikon në thirrje projektesh të ndryshme duke mbajtur në konsideratë objektivat dhe misionin e Fondacionit për të rritur bashkëveprimin rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.



 www.fqs.al

 secretary@fqs.al

 Sheshi Austria, 1001, Tiranë